VENDIM
Nr. 50, datë 3.5.2013

PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "EN.KU" SHPK ME NR. 10, SERIA PV03P, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 20, DATË 19.1.2003, MODIFIKUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 86, DATË 17.7.2008

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 13, 14 pika 2, 15 pika 1, pika 2 germa "b", pika 3 pika 4 të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, pikat 2.3 dhe 2.4 të licencës "Për prodhimin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.5.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "EN.KU" sh.p.k. për ndryshimin e licencës nr. 10, seria PV03P "Për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike", lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 20, datë 19.1.2003, modifikuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 86, datë 17.7.2008 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe të Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria "EN.KU" sh.p.k. plotëson kërkesat e "Rregullores së procedurave të licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Neni 15, pika 4, germa "a":

Informacioni me shkrim, ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës (është plotësuar tërësisht).

- Neni 15, pika 4, germa "b":

Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim licence (është plotësuar tërësisht).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Modifikimin e licencës së shoqërisë "EN.KU" me nr. 10, seria PV03P "Për prodhimin e energjisë elektrike" nga HEC "Bicaj" me fuqi 100 KW, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 20, datë 19.1.2003, modifikuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 86, datë 17.7.2008.
2. Fuqia e instaluar e HEC "Bicaj" nga 100 KW të bëhet 3.1 MW.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani